


SPECIFIKIME TEKNIKE

**Projekti i "Rikonstruksion i rruges
Golem-Mali i Robit"**



I. Paraqitje

Ky 'Specifikim Teknik', si dokument kontraktual, është hartuar enkas nga grupi i projektimit për projektin "Projekti Riokonstruksion i rruges Golem-Mali i robit, Njesia administrative Golem, Kavaje. Zerat e rradhitura në përmbajtje, janë pjesë dhe përshkrime të detajuara të vizatimeve të bera nga projektuesit. Standartet e përdorura në këtë 'Specifikim Teknik', nuk kanë qenë mbështetur vetëm në vizatimet por dhe në manualët ligjore dhe libra të tjere keshillues si:

Punime në rrugë

Gërmim dheu

Gërmim dheu për trupin e rruges në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thare ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trugjeve, gureve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³ skërfikim deri 10 cm.

Shtrese stabilizanti 1x5cm

cm, gran. 0/35mm.

Ky ze përfshin të gjitha proceset dhe materialet që duhen për ndërtimin e shtresës uniforme me trashësi 5cm cm të stabilizantit, pas përfundimit të skërfikimit të rruges. Në të përfshihet kostoja e blerjes së materialit, furnizimi, transporti, depozitimi shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5 – 6 kalime vajtje ardhje deri në ngjeshje 98%. Stabilizanti duhet të jetë me zall lavatrice me granulometri 0/35 mm, të behen provat e materialit që përdoret për plotësimin e kushteve teknike, për materialin që do të përdoret të lajmërohet përfaqësuesi i Investitorit. Vetëm pas miratimit me shkrim nga Supervizori do të lejohet përdorimi i materialit të stabilizantit. Çmimi i referohet 1 m².

Shtrese binderi me trashësi 5 cm.

Ky çmim përfshin koston për blerjen e materialit, furnizimin, shpërndarjen e binderit në një shtresë uniforme me trashësi 5 cm dhe cilindrimin e tij, pas përfundimit të shtresës uniforme e ngjeshur dhe profiluar mirë dhe sipas projektit të stabilizimit në të gjithë sipërfaqen e rruges me makineri, si dhe pastrimi nga papastërtitë e mundshme që të realizohet bashkimi i saj me shtresën e re. Për shpërndarjen e binderit duhet të behet sperkatja e sipërfaqes me përafërsisht 0,5 litra/m². Sasia e binderit duhet të jetë e tillë që të sigurojë pas rullimit trashësinë minimale të përcaktuar në projekt (5 cm). Shtrimi duhet të

behet me makine asfaltoshtruese. BINDERI ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes binderi duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat. Anet e shtreses se binderit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Çmimi i referohet 1 m².

Shtrese asfaltobetoni me trashesi 3 cm.

Ky çmim perfshin koston e blerjes se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e asfaltobetonit ne nje shtrese me trashesi 3cm. Paraprakisht duhet te behet pastrimi i siperfaqes nga te gjitha mbeturinat. Para shperndarjes se asfaltobetonit duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfaltobetonit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme minimale te percaktuar ne projekt (4 cm). Asfaltobetoni ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes, asfaltobetoni duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimin i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa. Çmimi i referohet 1 m².

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit teritorit